



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

Pejë 06.03.2024,

Në mbështetje të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092 dhe, autoriteti kontraktues Komuna e Pejës (ne vazhdim AK KK PEJE . apo Autoriteti Kontraktues) ka shqyrtuar Kërkesën për Rishqyrtim të operatorit ekonomik **TRAFFIKS VA SH.P.K** pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit **084 Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal ne Komunen e Pejës. , nrprok te brendeshem. 635-24-009-221 // 635-24-1274-2-2-1** dhe ne lidhje me kërkesën, nxjerr këtë:

VENDIM

Cilësohet e **pjeserisht e bazuara** kërkesat për ri-shqyrtim nga operatori ekonomik **TRAFFIKS VA SH.P.K** pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit **084 Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal ne Komunen e Pejës**

SQARIM

Me datën **06.03.2024**, operatori ekonomik **TRAFFIKS VA SH.P.K** ka parashtruar pranë Autoritetit Kontraktues (**KOMUNA E PEJES**) kërkesat për rishqyrtim me pretendimet si me poshtë:

-Në kërkesën për informata shtesë ne kemi paraqitur që
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 &; 9.2 Kërkesa 1 është kërkuar Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses minimum 2 kontrata te njejta (smart City ne shtetin tone) ne 5 (pese) vite e fundit duke filluar nga data e publikimit te njoftimit per kontrat. Në një vlerë prej jo me pak se 180,000.00 Euro, ne raste konzorciumi lideru duhet te kete te pakten 60% kontrata te natyres se ngjajeshme.
Duke e analizuar paramasën dhe paralogarinë ku do të kryhen sinjalizim horizontal, sinjalizim vertikal, kërkesa për minimumi 2 kontrata te njejta (smart City ne shtetin tone) është një kërkesë në kundërshtim me nenin 7-barazia ne trajtim/jo-diskrimini pasi që nuk do të ekzekutohen vetëm punë të smart city, por edhe sinjalizime te tjera andaj kërkojmë nga ana juaj që të rishihet dhe largohet kërkesa e tillë, pasi që është vetëm kërkesë në favorizim të kompanive të caktuara, një kërkesë e cila është në kundërshtim me rregulloren 001/2022 për prokurim punlik pika -54.9 ku është specifikuar qartas që AK nuk mund të përdor kontratat publike kornizë në mënyrë që të parandaloj dhe kufizoj konkurrencen, ku kërkesa për 2 kontrata të njëjta veq se e kufizon konkurrencën për këtë procedurë. Andaj kërkojmë nga ana juaj që kërkesa për 2 kontrata te njejta (smart City ne shtetin tone) të largohet.
Në përgjigjen saj përket kësaj pike ju keni cekur qe ka "Sa i perket kerkeses numer 1 te D.T ju njoftojm se keto pune jane pune te natyres se ngjajeshme dhe jan te specifikuara ne Paramasa paralogari gjegjesisht te Pika 3 , 3.1.3.2. dhe 3.3 dhe ketu kemi vepruar konform D.T"
Ne prap e shohim diskriminuese kerkesen pasi qe nuk është kërkuar që të ofrohet dëshmi që jane kryer punë për sinjalizimin Vertikal e Horizontal punë të cilat do të kryhen por vetem për pikën 3 , 3.1.3.2. dhe 3.3, është kërkuar të ofrohet dëshmi dhe si të tilla i ka veqar 2 kontrata (SMART CITY) dhe në 5 vitet e fundit në vlerë prej 180,000.00.
Ne e kemi të qartë vlerën e cila është kërkuar pasi që është konform ligjit, mirëpo kërkesa e veqar 2 kontrata (SMART CITY), ne e shohim kërkesë favorizuese për OE të caktuar dhe një kërkesë për të zvogëluar konkurrencën. Pasi që edhe në Udhëzuesin nr 001/2023 për prokurimin Publik 8.Kriteret e përzgjedhjes është e cekur që të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë të drejtëpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë, si dhe në 8.4-Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimi të OE dhe të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyshme dhe mjaftueshme ekonomike, financiare dhe ose teknike.
Gjithashtu për këtë pikë është specifikuar edhe qartas që tabelën e përgjedhjes që mund të përdoren nga AK, në Kërkesat minimale të kualifikimit, 3.Aftësitë teknike dhe/ose profesionale për shërbime ku është e cekur vlera minimale e shërbimit në 3 vitet e fundit, ndersa AK ka kërkuar 5 vite te fundit veq për favorizim të OE të caktuar.

III. Shënim për kërkesat e ofruesve teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):

- Në përputhje me ligjin e prokurimit publik, AK mund të kërkojë nga OE një listë të projekteve të realizuara në 3 vitet e fundit. Kësaj liste duhet t'i bashkëngjiten si dëshmi:
 1. Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata raport pasimi/ reference) të venditësive të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë, të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar.
 2. Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e qdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidencimi i livrimit të tillë;
- Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim shënjë: " të realizuara (përfunduar) në të cilat e shkuan 3 ose 2 në nënshkrimin e shkuan (përfunduar) ". Në kuptimin e Ligjit shprehja "të shkuan" nënkupton: " periudhën kohore të përcaktuar në kësaj neni e cila ndërkohë në periudhë të parapërditur datën e publikimit të kontratës, shërbimin e bërë për pjesëmarrje ose tenderin.
- Në kuptim të nenit 69 paragrafi 2.1, 4.2 dhe 6.2 shprehja "...te realizuara në tre vitet e shkuan" nënkupton Kontratën për furnizimin, shërbimin dhe/ose punë të realizuara (përfunduar) në periudhën e shkuan tre vjeçare (periudha e sqaruar si më lart).
- Në këto situata rekomandohet që data nga e cila fillon të kalkulohet periudha e shkuan tre vjeçare të vendoset data e publikimit të shërbimit për kontratë përkatëse dhe dërgimit të Resës për pjesëmarrje.

31

UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Kështu: Shumë AK i aplikojnë kërkesat e nenit 68 dhe/ose 69 të LPP se edhe për rastet kur nuk kanë ndonjë rëndësi apo nevojë për tu dëshmuar (p.sh. për aktivitetet të cilat kanë për qëllim furnizimin me mallra e të cilat nuk prodhohen nga ofruesi i tyre). Në këto aktivitete aplikimi i kërkesave nga neni 68 dhe/ose 69 të LPP nuk është i arsyeshëm për kontratën e shkuan dhe mund të shkaktojë probleme të panevojshme.

Ku nga këto që sqaruum më lartë shihet qartas që kërkesa është në kundërshtim me ligjet, udhëzuesit dhe rregulloret e prokurimit publik.

Në kërkesën për sqarim ne kemi kërkuar gjithashtu edhe sqarim për kërkesat si në vijim ashtu siq e parashikohet edhe Rregulloja 001/2022 për prokurim publik neni 24-Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjidhet e afatëve kohore, ku nuk kemi pranuar asnjë sqarim për këto pika si dhe asnjë ndryshim në formular për të:

Në -Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 në dosjen e tenderit dhe njoftimit përkontratë:
 Kërkesa 4 Operatorët ekonomik duhet të dorëzoj MAF nga prodhuesi për sinjalizime horizontale (ngjyrosje) dhe vertikal (folies reflektuese dhe tabloje).
 Kërkesa 6 Operatorët ekonomik duhet të dorëzoj Certifikatën e prodhuesit 3M (për folien adezive).
 Kërkesa 7 Me qoftë duhet të prezantohen mostrat e folieve DG dhe EGP , si dhe mostrat e panelit të aluminit i cili do të përdoret

Në kërkesat e lartëcekura është kërkuar MAF nga prodhuesi, 3M nga prodhuesi, DG dhe EGP, duke e parë specifikimin e prodhuesve ne kemi parashtruar kërkesë për sqarim dhe tash kërkesë për rishqyrtim pasi që edhe në rregulloren 001/2022- neni 17-Dosja e tenderit është e specifikuar qartas që Asnjë specifikim nuk do të lëshohet me referencëndaj një marke të caktuar tregtare, emër të brendit, patentë, dizajn, lloj, origjinë

4/3

PERGJIGJET E AK NE PRETENDIMIN TRAFIKS VA SH.P.K:

Ne si A.K Komuna e Pejës ju njoftojm se do veprojm konform rm **LPP-se** dhe ju njoftojm se te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale , KERKESA 1

Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses minimum 2 kontrata te njejta (smart City ne shtetin tone) ne 5 (pese) vite e fundit duke filluar nga data e publikimit te njoftimit per kontrat.Ne nje vlere prej jo me pak se 180.000.00 Euro,ne raste konzorciumi lideru duhet te kete te pakten 60% kontrata te natyres se ngjajeshme. Ju njoftojm se ky kriter ki kerkuar ne kerkesen 1 korrigjohet ne perputhje me LPP-ne,

Sa i perket te lista e paisjeve ju lutem se ne si A.K me daten 01.03.2024 kemi bere ndryshimin e deshmis ku kemi kerkuar si ne vijim **Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimi me validitet , ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj).**

Vëmendje!

Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit.

Deshmit e kerkuara jan konform LPP-se dhe Marreveshjet duhet te jene te noterizuara pasi qe edhe ky projekt eshte kontrat korniz dhe paisjen per kete projekt jane te deomosdoeshem per implementimin sa me te mir te sherbimeve, dhe do ju njoftojm se korrigjimet do ti keni ne **B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara.**

Sinqerisht,

Milot Gashi
Menaxher i Prokurimit

